



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1942/ 10 prot.

Datë 19.09.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1284/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.09.2024, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-09833-06-19-2024, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Ministrinë e Financave*”, me fond limit 8,000,000 (*tetë milion*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2024, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Alstezo” SHA, me NIPT J63208420N dhe me adresë: Zhupan, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.  
Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me NIPT L01314031G, me adresë: Rruga “Kavajës”, Lalm Nd. 2 kat, Kati 2, Km 6, Vaqarr, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e*

*Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtar, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-09833-06-19-2024, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Ministrinë e Financave*”, me fond limit 8,000,000 (tetë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 04.07.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 04.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vilnik Motors” SHPK	5,567,000	kualifikuar
2. “Alstezo” SHA	5,600,000	kualifikuar
3. “Servis Auto 2000” SHPK	5,700,100	kualifikuar
4. “Auto Manoku” SHPK	5,840,000	kualifikuar
5. “DBD Group/Besnik Maçi” SHPK	6,087,960	kualifikuar
6. “Kadiu” SHA	7,773,300	kualifikuar
7. “Amarildo Panda” PF	7,900,000	skualifikuar

II.4. Në datën 11.07.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraparak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 16.07.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi A/2024/4330 dhe nr. 1942/2024 protokoll, datë 16.07.2024 i operatorit ekonomik “Alstezo” SHA, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit, me argumentet si më poshtë vijon:

*E kundërshtojme këtë klasifikim si dhe vendimin e Autoritetit Kontraktor për shpalljen fitues të Operatorit Ekonomik Vilnik Motors me argumentimin, si më poshtë:*

*A- Në DT, në Shtojcën 8 - Formulari i Kritereve të Perzgjedhjes/Kualifikimit, tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit., Pika 2.3.4 Kapaciteti Teknik, kërkohet: 2. Ofertuesi duhet të paraqesë: 2.3 për kapacitetin teknik: 2.3.4 operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve në DST. Meqenëse operatori ekonomik Vilnik Motors sh.p.k është shpallur fitues, atëherë sipas parashikimeve të Nenit 26/6 të LPP-se, kjo kompani duhet të ketë dorëzuar fizikisht dokumentet e këtyre punonjesve, perkatesisht si më poshtë: - kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto ose bojaxhi dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër. - dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, mbi arsimin dhe formimin profesionalë, i ndryshuar. Nderkohe që kërkohet gjithashtu që dokumentet e mesipërme të kërkuara nga AK kjo kompani duhet të ketë deklaruar në Shtojcën 9 të DT (kjo shtojcë është dorëzuar në momentin e paraqitjes së ofertës).*

*Ky operatori ekonomik NUK KA në staf, 1 (një) motorrist të pajisur me ...dëshmi të aftësisë profesionale për MOTORRIST në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë.. Gjithashtu NUK KA ...kontraten e punës të vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorrist dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

*Ky operatori ekonomik NUK KA ne staf, 2 (dy) XHENERIKE te pajisur me ....dëshmi të aftësisë profesionale per XHENERIKE ne perputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë.. Gjithashtu NUK KA ..kontraten e punes per 2 punonjes te vlefshme, ku të specifikohet pozicioni i tyre perkatesisht si XHENERIKE dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

*Ky operatori ekonomik NUK KA ne staf, 1 (një) motorrist te pajisur me ...dëshmi të aftësisë Profesionale per ELEKTROAUTO ne perputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu NUK KA ..kontraten e punes te vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si ELEKTROAUTO dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

*Ky operatori ekonomik NUK KA ne staf, 1 (një) motorrist te pajisur me ..dëshmi të aftësisë profesionale per BOJAXHI ne perputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (Ligji Nr. 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu NUK KA ...kontraten e punes te vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si BOJAXHI dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.*

*Ne perfundim, nisur nga sa me siper kerkojme skualifikimin e operatorit ekonomik Vilnik Motors sh.p.k sepse nuk ka plotesuar kriterin kualifikues te Pika 2.3 Kapaciteti teknik, Pika 4 te Shtojces 8 Formular i Kriereve te Perzgjedhjes/Kualifikimit, Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për ministrinë e Financave.*

*B - Ne DT, në Shtojcen 8 - Formulari i Kriereve te Perzgjedhjes/Kualifikimit, tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit., Pika 2.3.5 Kapaciteti teknik, nënpika 5 kërkohet: 2. Ofertuesi duhet të paraqesë: 2.3 për kapacitetin teknik: 2.3.5. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë b) pajisje bango provë, për motorrin dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; dhe l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë.*

*Pajisjet që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Shënim 5.1: operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe insntrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).*

*Ne kete kriter Autoriteti Kontraktor (AK) ka kerkuar qe ofertuesi te disponoje ne ambientet e punes se tij pajisje dhe instrumenta per realizimin e kontrates qe prokurohet, ku ndër të tjera kërkohen dhe këto pajisje, si vijon: b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator*

(dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; dhe l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë.

Per me teper, AK ka kerkuar qe ... Ofertuesi per te vertetuar se i disponon keto pajisje duhet te paraqese njerin prej dokumentave te meposhtem: - fatura blerje ose - dokumente zhdoganimi ose - kontrata qiraje ose - kontrata huapërdorje ose - kontratë dhurimi ose - cdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Meqenese operatori ekonomik "Vilnik Motors" sh.p.k eshte shpallur fitues, atëhere sipas parashikimeve te nenit 26/6 te LPP-se, ky operator ekonomik duhet të kete dorezuar fizikisht njerin prej dokumentave te siperpermendur dhe qe kjo kompani duhet ti kete deklaruar ne Shtojcen 9 te DT-ve (kjo shtojce eshte dorezuar ne momentin e paraqitjes se ofertes). Ky operator ekonomik jo vetem qe nuk disponon fizikisht ne ambientin e punes se saj pajisje, si vijon: b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; dhe l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë, por edhe dokumentacioni fizik i dorezuar prej tij nuk perputhet me deklarimet e bëra prej tij ne Shtojcen 9 (te dorezuar prej tij) dhe se ky dokumentacion fizik nuk permbush kriterin kualifikues te Pika 2.3 Kapaciteti teknik, Pika 5, persa i perket kërkesës se disponimit te ketyre pajisjeve. Përfundimisht, duke u mbështetur ne Ligji Nr.162/2020, dt.23/12/2020 Për Prokurimin Publik, V.K.M. Nr.285, Datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik si edhe Ligji, Nr. 16/2024 Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, kërkojmë,

1. Pezullimin e procedurës së prokurimit.

2. Skualifikimin e kompanisë Vilnik Motors sh.p.k., pasi:

A- NUK permbush Kriterin 2.3 për kapacitetin teknik, Pika 4, pra NUK disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve : 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti, 1 (një) motorist ; 2 (dy) xhenerikë ; 1 (një) elektroauto dhe 1 (një) bojaxhi.

B - NUK permbush Kriterin Pika 2.3 Kapaciteti teknik, Pika 5, pra NUK disponon te gjitha pajisjet dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, konkretisht: b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; dhe l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë”.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1942/2 prot., datë 17.07.2024,

duke publikuar kriteret e kualifikimit të cilat ankimuesi “Alstezo” SHA pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.

II.5.2. Me anë të shkresës Nr. 733/8 prot., datë 26.07.2024, protokolluar me tonë me nr. 1942/3 prot., datë 31.07.2024, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHA, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë me përmbajtje si më poshtë vijon:

Komisioni i shqyrtimit të ankesës pas shqyrtimit të ankesës, si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga njësia e prokurimit,

*Arsyeton:*

*Ne lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “ALSTEZO” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “VILNIK MOTORS” sh.p.k., zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës gjykon se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori për disa kritere kualifikimi, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse plotëson pjesë të kritereve të vendosura në DST operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” shpk i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.*

*Referuar nenit 111 “Paraqitja e ankesës”, pika 2 e ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet:*

*2. Ankesa behet sipas formularit perkates, ku shenohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat perkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpermendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkelidhe ankimit dokumentin bankar që verteton pagesën e tarifës perkatëse për ankesën.*

*Zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indice dhe argumente ose dokumentacionin perkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin që ta bejë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe sakte se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatoreve ekonomike të tjere.*

*KSHA gjykon se është në drejtë të operatoreve ekonomike të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertes së operatoreve të tjere ekonomike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomike ankimues nuk mund të parashtrorjnë pretendime a-priori duke iu referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vete Kodi i Procedurave Administrative*

ka parashikuar ne nenin 82 pika 1 te tij se “Në procedurat administrative, te filluara me kerkese te pales qe inicion procedurën, barra e proves per faktet e pretenduara bie mbi kete pale, pavaresisht nga detyrimi i organit publik per te venë në dispozicion te paleve provat e zoteruara prej saj”. Nje ankim pa argumente te arsyeshme apo indice te qarta, mbi te gjithë apo nje pjese te elementeve perberes te ofertes se konkurrentit/konkurrentëve te kualifikuar perpara tij, bazuar ne LPP dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij, konsiderohet abuziv dhe cenon efikasitetin dhe shpejtesine e procedures se prokurimit publik dhe nuk do te merret ne shqyrtim nga KSHA.

Per sa me siper, pretendimet e OE nuk qëndrojnë.

#### Për Këto Arsye

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, zyrtari i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

#### Vendosi

1. Refuzimin e ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik “ALSTEZO” ShPK.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomik të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qendror Blerës.

II.5.3. Me anë të shkresës nr. 1942/4 prot., datë 13.08.2024 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Alstezo” SHA”, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar autoritetit kontraktor, duke kërkuar informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, konkretisht:

“[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vetëm informacion si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vetëm dokumentacionin e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK të paraqitur pranë autoritetit kontraktor në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 9 të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, ashtu sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

*pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

*Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së enjte datë 15.07.2024. [.....]*

II.5.4. Me anë të shkresës Nr. 733/12 prot., datë 20.08.2024, protokolluar me tonë me nr. 1942/5 prot., datë 21.08.2024, me objekt “Dërgohet dokumentacion i operatorit ekonomik Vilnik Motors SHPK”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga shoqëria “Vilnik Motors” SHPK.

II.5.5. Me anë të shkresës nr. 1942/6 prot., datë 17.09.2024, me objekt “Kërkesë për paraqitje provash”, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar subjektit të interesuar “Vilnik Motors” SHPK, duke kërkuar informacion, konkretisht:

*Me shkresën nr. 1942/4 prot, datë 13.08.2024 Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke i kërkuar që të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK të paraqitur pranë autoritetit kontraktor në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 9 të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, ashtu sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me shkresën nr. 733/12 prot, datë 20.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1942/5 prot, datë 21.08.2024 autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik dokumentacion e kërkuar. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” me shkresën nr. 1/5 prot, datë 05.07.2024, konkretisht faturave të blerjes së pajisjeve, Komisioni shfaq vështirësi në evidentimin e **pajisjes për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes**, në faturat e dorëzuara nga ana juaj për shkak të paqartësisë së përshkrimit të mallit në faturë.*

*Ndaj për sa më sipër, me qëllim shqyrtimin e ankesës të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHA dhe dokumentacionit tuaj provues të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe*



*Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e dokumentacionit provues se më cilën nga faturat e dorëzuara nga ana juaj pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1/5 prot, datë 05.07.2024, ju e provoni disponueshmërinë e kësaj pajisje.*

*Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” përcaktohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

*Për sa më sipër kërkojmë nga ana juaj të paraqisni dokumentacionin e nevojshëm brenda datës 19.09.2024, ora 12:00, i cili duhet të korrespondojë me dokumentacion e dorëzuar nga ana juaj pranë autoritetit kontraktor.*

II.5.6. Me datë 17.09.2024 operatori ekonomik i interesuar “*Vilnik Motors*” SHPK ka paraqitur dokumentet provuese (të kërkuara nëpërmjet shkresës nr. 1942/6 prot, datë 17.09.2024 nga KPP) nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të cilat janë protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1942/7 prot., datë 18.09.2024, me objekt “Paraqitje dokumentacioni të nevojshëm për procedurën me objekt “*Riparim dhe Mirëmbajtje Automjetesh për Ministrinë e Financave*”.

II.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Alstezo*” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se: “[...] A- Nuk permbush Kriterin 2.3 për kapacitetin teknik, Pika 4, pra NUK disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve : 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti, 1 (një) motorist ; 2 (dy) xhenerikë ; 1 (një) elektroauto dhe 1 (një) bojaxhi. B – Nuk përmbush Kriterin Pika 2.3 Kapaciteti teknik, Pika 5, pra NUK disponon te gjitha pajisjet dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, konkretisht: b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për

kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; dhe l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë” [...]. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.a, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është përcaktuar kriteri si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

III.1.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4 dhe 2.3.5 “Kapaciteti Teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi janë përcaktuar kriteret si më poshtë:

2.3.4. *Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë të pakten 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorist,
- c) 2 (dy) xhenerikë,
- d) 1 (një) elektroauto,
- e) 1 (një) bojaxhi.

*Në lidhje me punonjësën në pikën (a), duhet të paraqitet:*

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale
- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

*Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e më sipër duhet të paraqitet:*

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, elektroauto ose bojaxhi dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.*

*Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.5. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisje dhe instrumente të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit, të paktën 1 (një) copë;
- b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;
- d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- e) Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit.
- f) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;
- g) pajisje urë ngritëse për automjetet, të paktën 2 (dy) ura për mjetet objekt prokurimi.
- h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit;
- i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- j) pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- k) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit;
- l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.3. Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

### Shtojca 9.

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
---------------------	-------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----  
Numri NIPT/et:	----- ---
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ----
E-mail:	----- -----

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-</p>

<p>vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
  
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
  
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e



medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

### **Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

#### **A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### **B: DEKLARATË**

##### **Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

*Ju lutemi sigurohuni që:*

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "Vilnik Motors" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku ka deklaruar se ka të punësuar 25 persona. Konkretisht, ndër të tjera ka deklaruar se disponon a) 1 Inxhinier Mekanik, b) 1 (një) motorist, c) 2 (dy) xhenerikë, d) 1 (një) elektroauto, e) 1 (një) bojaxhi të kualifikuar sipas formimit profesional me Diplomë për inxhinierin mekanik dhe Dëshmi Kualifikimi të lëshuara nga institucione shtetërore për punonjësit e tjerë. 30 punonjës shërbimi/sanitar (specifikuar me emrat përkatës), si dhe një punëtor lartësish (z. Sh.L). Gjithashtu, operatori ekonomik "Vilnik Motors" SHPK, në këtë formular ka deklaruar se disponon dhe pajisjet si vijon: **a)** Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit; **b)** Pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); **c)** Pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete; **d)** pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C; **e)** Pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit; **f)** Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v; **g)** Pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura per mjetet objekt prokurimi; **h)** Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; **i)** Pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; **j)** Pajisje për zëvendësimin e vajit të motorrit; **k)** Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskut e gomës të mjetit; **l)** Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe,

sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

**2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

**“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.7. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: I.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.8. Ndërsa në nenin 41, pika 4 gërma c dhe ç të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet, se është plotësuar sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.

III.1.10. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “*Vilnik Motors*”, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, në lidhje me punonjësit dhe pajisjet, ka deklaruar, se ka në stafin e tij punonjësit dhe pajisjet e kërkuara.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, nuk disponon *1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti; 1 (një) motorist; 2 (dy) xhenerikë; 1 (një) elektroauto; 1 (një) bojaxhi dhe pajisjet b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë.* KPP nga verifikimi i Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka deklaruar se disponon 25 persona të punësuar. Konkretisht, ndër të tjera ka deklaruar se disponon a) 1 Inxhinier Mekanik, b) 1 (një) motorist, c) 2 (dy) xhenerikë, d) 1 (një) elektroauto, e) 1 (një) bojaxhi të kualifikuar sipas formimit profesional me Diplomë për inxhinierin mekanik dhe Dëshmi Kualifikimi të lëshuara nga institucione shtetërore për punonjësit e tjerë. 30 punonjës shërbimi/sanitar (specifikuar me emrat përkatës), si dhe një punëtor lartësish (z. Sh.L). Gjithashtu, operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK, në këtë formular ka deklaruar se disponon dhe pajisjet si vijon: *a) Pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit; b) Pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); c) Pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete; d) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C; e) Paisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit; f) Pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v; g) Pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 2 (dy) ura per mjetet objekt prokurimi; h) Pajisje*

*për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) Paisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; j) Paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit; k) Paisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit; l) Paisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.*

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në pjesën III, është plotësuar pika B “DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive, ku konstatohet, se janë deklaruar punonjësit dhe makineritë/pajisjet që disponon.

Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Alstezo” SHA, për skuafikimin e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, me anë të shkresës nr. 1942/4 prot., datë 13.08.2024, i kërkoi autoritetit kontraktor, në mbështetje të nenit 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, i renditur i pari.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 733/12 prot., datë 20.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1942/5 prot., datë 21.08.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, gjithsej 209 faqe.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, në përmbushje të kriterit për punonjësit e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarimeve të tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për punonjës **1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti** (z. Sh.L), ka paraqitur 1- Kontratë Individuale pune, datë 17.11.2021 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. Sh.L si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “ *I punësuar z. Sh. L, pranon të punojë si Drejtues Teknik në profesionin Inxhinier Mekanik*”, 2- Diplomë e Nivelit të Parë dhe Master në Inxhinieri Mekanike. Për punonjës **1 (një) motorist** (z. A. A), ka paraqitur 1- Kontratë Individuale pune, datë 19.03.2019 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. A. A si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “ *I punësuar z. A. A, pranon të punojë në profesionin motorrist automjetesh, 2- Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës me formim Motorrist*. Për punonjës **2 (dy) xhenerikë** (z. E. GJ dhe z. E. K), ka paraqitur 1- Kontratë Individuale pune, datë 01.01.2019 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. E. GJ si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “ *I punësuar z. E. GJ, pranon të punojë në profesionin xhenerik automjetesh, 2- Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës me formim Xhenerik*. 2- Kontratë Individuale pune, datë 23.07.2022 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. E. K si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “ *I punësuar z. E. K, pranon të punojë në profesionin xhenerik automjetesh, 2- Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Lëvizëse me formim Xhenerik*. Për punonjës **1 (një)**



**elektroauto**, (z. V. GJ), ka paraqitur 1- Kontratë Individuale pune, datë 02.03.2018 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. V. GJ si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “*I punësuar z. V. GJ, pranon të punojë në profesionin elektroaut dhe diagnostifikues difektesh elektrike dhe elektronike për automjetet dhe agregatet elektrike, 2- Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Nr. 4 Tiranë me formim Elektroaut. Për punonjës in 1 (një) bojaxhi.*, (z. SH. XH), ka paraqitur 1- Kontratë Individuale pune, datë 15.12.2022 midis shoqërisë “Vilnik Motors” SHPK si Punëdhënës dhe z. SH. XH si punëmarrës, me afat të pacaktuar, me përshkrim “*I punësuar z. SH. XH, pranon të punojë në profesionin bojaxhi për automjete, 2- Dëshmi Kualifikimi të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Lëvizëse me formim llamarinist dhe bojaxhi automjetesh.*

Ndërkohë në përmbushje të kriterit për pajisjet **b) pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo); h) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit; i) pajisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes; l) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë**, Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, në përmbushje të kriterit për pajisjet e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarimeve të tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për pajisjen **bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo)** ka paraqitur faturën tatimore të shitjes me nr. 43, datë 23.02.2021, për pajisjen **për kontrollin në presion të difektimit të cilindrave dhe testatave të motorrit** ka paraqitur faturën tatimore të shitjes me nr. 18, datë 08.07.2020, për pajisjen **për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes** ka paraqitur faturën tatimore të shitjes me nr. 202, datë 06.04.2017, për pajisjen **për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjetë** ka paraqitur faturën tatimore të shitjes me nr. 100, datë 23.03.2010, nr. 111, datë 15.05.2010, nr. 87, datë 22.04.2020,

III.1.11. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Në rastin konkret, duke qenë se operatori ekonomik “Vilnik Motors” ShPK është kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, u konstatua se operatori ekonomik disponon në stafin e tij *punonjësit dhe mjetet e kërkuara në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të autoritetit

kontraktor, duke përmbushur kështu kriteret e kualifikimit në lidhje me këta punonjës dhe pajisje.

III.1.12. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon punonjësve dhe pajisjeve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pra, në rastin konkret KPP gjykon, se operatori ekonomik “*Vilnik Motors*” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, si operator ekonomik i kualifikuar i pari, përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit në lidhje me punonjësit dhe pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Alstezo*” SHA nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “*Alstezo*” SHA për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr.REF-09833-06-19-2024, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Ministrinë e Financave*”, me fond limit 8,000,000 (tetë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.07.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

